



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 257, Datë 21.12.2021

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER 2” SH.P.K., NË  
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 13, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 156/7 prot., datë 17.12.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatohet se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 238, datë 26.11.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
- ERE me shkresën nr. 6/24 prot., datë 26.11.2021, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta (data 14.12.2021), nuk rezultoi të ketë të tilla, në lidhje me këtë aplikim.
- Me shkresën nr. 1074/1 prot., datë 02.12.2021, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësimin e dokumentacionit të munguar sipas vendimit nr. 238/2021”.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet

*për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.*

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën përfundimtare të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, si më poshtë vijon:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar.**
  - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8 , gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
- Në lidhje me dokumentacionin e plotësuar pjesërisht:
  - neni 9, pika 2
  - **gërma “e”** (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse), shoqëria ka përcjellë në ERE strukturën e organizimit të saj, ku përfshihet administratori, përgjegjësi i nënstacionit, si dhe elektrikistët dhe ndihmëselektricitët e nënstacionit, por në kuadër të kësaj licence, ajo duhet të përcjellë në ERE strukturën e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të saj, në përputhje me ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Shoqëria “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., të depozitojë në ERE brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani, strukturën e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të saj, në përputhje me ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.
3. Mosplotësimi i kushtit të mësipërm përbën shkak për rishikimin e këtij vendimi.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**